


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

Adresa: Blv. "Bajram CURRI" Tiranë Albania, Tel./fax +3554 362937 : eëë.moh.gov.al

Nr. 3715 Prot.

Datë, 26/10/2009

U D H Ë Z I M

Nr. 558 Datë 26/10/2009

PËR RREGJISTRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE LËVIZJEN E PACIENTIT
BRENDA INSTITUCIONEVE SHËNDETSORE,
NË ZBATIM TË SISTEMIT TË REFERIMIT

Në zbatim të nenit 28, të ligjit nr. 10108, datë 30.03.2009 «Për shërbimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë» si dhe Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 526, datë 12.10.2009, "Për zbatimin e sistemit të referimit në shërbimin shëndetësor", për një organizim dhe disiplinim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore ndaj pacientit, në sistemin parësor, dytësor dhe atë terciar:

U D H Ë Z O J

- 1- Në çdo institucion shëndetësor publik që kryejnë vizita, ekzaminime dhe konsulta mjekësore, të vendoset zyra e recepsionit dhe arkëtimit.
- 2- Pika e parë e kontaktit e pacientit në një institucion shëndetësor do të jetë recepsioni.
- 3- Recepsioni bën planifikimin e vizitave dhe konsultave sipas shërbimit, ku përcakton mjekun, ditën, dhe orën. Planifikimi i vizitave bëhet nëpërmjet telefonit ose duke shkuar pranë institucionit që ofron shërbimin. Punonjësi i recepsionit, çdo ditë, printon dhe shpërndan pranë mjekëve përkatës, grafikun e vizitave të planifikuara.
- 4- Pacienti kur paraqitet te mjeku i tij i familjes, do të identifikohet pranë recepsionit me librezën e shëndetit dhe mjetin e identifikimit. Kur pacienti është referuar për konsultë të specializuar ose ekzaminime të ndryshme, duhet të paraqesë edhe rekomandimin përkatës.

5- Receptsi duhet të jetë i pajisur me telefon, kompjuter, regjistër për vizitat (të printuar ose elektronik).

6- Receptsi duhet të regjistrojë gjeneralitetet e pacientit, kodin e mjekut dhe të qendrës shëndetësore nga rekomandohet, arsyeja pse është rekomanduar, i siguruar/i pasiguar, numrin e librezës së shëndetit, kodin e pacientit.

7- Drejtoria e institucionit pajis receptsin me grafikët e shërbimeve për vizitat, ekzaminimet, konsultat, duke përcaktuar datat, orarin dhe emrat e dhënësve të shërbimit.

8- Receptsi pajis pacientin me mandat-arkëtimin përkatës.

- Kur pacienti paraqitet në qendrën shëndetësore, për të marrë shërbim:

a) Për pacientët e siguar do të lëshohet nga receptsi një mandat-arkëtim ku shënohet shërbimi që kërkohet si dhe "i siguar", që tregon se nuk është nevoja të paraqitet pranë arkës për të kryer pagesën.

b) Pacientët e pasiguar do të pajisen me mandat-arkëtim ku shënohet shërbimi që do të marrin si dhe vlera e shërbimit, dhe pasi të kryejnë pagesën, me mandatin e vulosur „U pagua” do të shkojnë në shërbimin e kërkuar.

- Kur pacienti paraqitet për konsultë të specializuar ose ekzaminime të ndryshme, në institucionet e specializuara:

a) Për pacientët e siguar dhe të rekomanduar, do të lëshohet nga receptsi një mandat-arkëtim ku shënohet shërbimi që kërkohet si dhe "i siguar dhe i rekomanduar", i cili tregon se nuk është nevoja që të paraqitet pranë arkës për të kryer pagesën.

b) Pacientët e pasiguar, si dhe pacientët e siguar por që nuk janë rekomanduar, do të pajisen me mandat arkëtim ku shënohet shërbimi që do të marrë si dhe vlera e shërbimit, dhe pasi të kryejnë pagesën në arkën e institucionit, me mandatin e vulosur „U pagua”, do të shkojnë në shërbimin e kërkuar.

9- Mandat-arkëtimi duhet të përmbajë këto të dhëna: Emrin e institucionit, numërin serial, numërin rendor, datën, emrin- mbiemrin - atësinë e pacientit, ku referohet për konsultë ose ekzaminim, shumën e lekëve, firmën e pacientit, firmën e arkëtarit. Mandati arkëtimit lëshohet në 3 (tre) kopje: një e mban pacienti, një qëndron te arka dhe një te mjeku ku merr shërbimin.

10- Nëse mjeku ku është referuar pacienti, pasi kryen vizitën e shikon të arsyeshme që pacienti duhet të konsultohet edhe me një mjek specialist tjetër brenda institucionit, i lëshon pacientit një rekomandim të brëndshëm, ku shënohet arsyeja e rekomandimit dhe mjeku te i cili rekomandohet.

11- Nëse mjeku specialist e shikon të arsyeshme për vendosjen e diagnozës, që pacienti duhet të kryejë ekzaminime laboratorike apo imazherike, e referon pacientin me rekomandimin e brëndshëm. Pacienti me rekomandimin duhet të kthehet te receptsi, i cili e pajis me mandat arkëtim.

a) Për pacientët e siguruar të cilët janë rekomanduar, do të lëshohet mandat arkëtimi ku të shënohet ekzaminimi që rekomandohet si dhe "i siguruar dhe i rekomanduar", gjë që tregon se nuk është nevoja të paraqitet pranë arkës për të kryer pagesën.

b) Pacientët e pasiguruar, si dhe pacientët e siguruar por që nuk janë rekomanduar, do të paisen me mandat arkëtimi ku shënohet ekzaminimi që do të kryej si dhe vlera përkatëse, sipas tarifave të miratuara, duke vazhduar më tej procedurën e përcaktuar në pikën 8, të këtij udhëzimi.

12- Pacientët e pasiguruar, do të paguajnë sipas tarifave të miratuara, për çdo shërbim që do të marrin, edhe nëse janë të rekomanduar.

13- Mjeku që bën vizitën duhet të shënojë në regjistrin: kodin e pacientit, numrin e mandatit si edhe diagnozën me të cilën evidentohet pacienti.

14- Cdo kabinet i konsultës apo ekzaminimit, duhet të ketë regjistrin e vet të konsultave dhe ekzaminimeve.

15- Mjeku specialist plotëson përgjigjen e rekomandimit ku shënon diagnozën, si dhe përshkruan trajtimin përkatës bazuar në udhëzimet e ISKSH-së.

16- Në pranim urgjencën e institucioneve me shtretër duhet të funksionojë rregullisht filtri i shërbimeve dhe argumentimi i karakterit urgjent/i zakonshëm, sipas protokollit përkatës të miratur nga Ministria e Shëndetësisë.

17- Institucionet shëndetësore publike janë të detyruara të publikojnë për publikun, shërbimet shëndetësore të ofruara prej tyre, si dhe tarifat përkatëse.

18- Institucionet shëndetësore janë të detyruar që të publikojnë në vende të dukshme, rregullat e funksionimit të sistemit të referimit, numrat telefonik të kontaktit, oraret e vizitave ambulatorë sipas specialiteteve, mjekun përkatës, komisionet e specialiteteve si edhe ato mjeko-ligjore, vendin ku ofrohen vizitat, tarifat e shërbimit për personat e pasiguruar apo të rekomanduar. Me qëllim mirëorientimin e pacienteve brënda institucionit shëndetësor, duhet të vendoset sistemi i tabelave orientuese.

19- Ngarkohen drejtoritë e institucioneve shëndetësore (qendra shëndetësore, spitale, poliklinika të specialiteteve), për zbatimin e këtij udhëzimi.

20- Ngarkohen Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Planifikimit Spitalor dhe Drejtoria e Auditit, në Ministri të Shëndetësisë si dhe ISKSH, për monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

21 - Cdo akt/urdhëresë e mëparshme e dalë nga, Ministria e Shëndetësisë apo Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në zbatim të sistemit të referimit dhe që bien ndesh me këtë udhëzim, çfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

